



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 2

Rrogozhinë, më 27.02.2023 ora 14 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.751.Prot datë 27.02.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.1, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 20.01.2023.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e planit të emergjencave civile 2023 dhe dokumentin për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut për Bashkinë Rrogozhinë”.
- 6- Miratim e projekt-vendimit, “Për mbylljen e disiplinimin e varrezës të fshatit Zeshtik, Njësia Administrative Kryeviidh”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit ‘Rrugët sipër hekurudhës’ faza e I-rë”.
- 8- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
- 9- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Emiliano Aliu, Petrit Haska, Vojsava Pipa, Luan Sheshi, Reshit Kala, Enver Memolla, Avni Kasa, Fatmira Thartori, Mejte Saliu, Alime Hoxha, Margarita Dedej, Anjeza Proshka, Mukades Gixhari.



Mungojnë :

Alban Sula, Haqim Tosku, Agim Pepa, Sheqere Biba, Fatjon Biba, Lulzim Hasa, Erind Tosku.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Andi Proshka - Drejtor i Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë, Kullimit dhe Vadiçjes.
4. Geraldo Gjini - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Adriatik Leka - Përgjegjës i sektorit të Emergjencave Civile.
6. Luan Gjuzi - Përgjegjës i sektorit juridik.
7. Ledian Hasani – Përgjegjës i Shërbimit Social.
8. Mario Meka - Përgjegjës i zyrës IT
9. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 12 Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : z. Emiliano Aliu, z. Petrit Haska, znj. Vojsava Pipa, z. Luan Sheshi, z. Reshit Kala, z. Enver Memolla, z. Avni Kasa, znj. Fatmira Thartori, znj. Mejte Saliu, znj. Alime Hoxha, znj. Margarita Dedej dhe Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 12 Këshilltarë.

Kalojmë në leximin e “Verifikimit Ligjor” ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për vendimet e



Këshillit Bashkiak të datës 20.01.2023. Lexon nënkryetari z. Emiliano Aliu. Emiliano fjala për ju.

Emiliano Aliu . Faleminderit, atëherë “Verifikim ligjshmërie” ardhur në datën 27 Janar 2023, Nr.127/1.Prot nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Këshillit Bashkiak Rrogozhinë, bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 gërma a, neni 16, gërma 2/a dhe Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Prefekti i Qarkut Tiranë verifikoi ligjshmërinë e vendimeve nr.1-2, datë 20.01.2023 të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Për sa më sipër,

Vendimi nr.1, datë 20.01.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2022 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% “ është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr .2, datë 20.01.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor” është në përputhje me ligjin.

Mukades Gixhari . Ju faleminderit Emiliano. Ju bëj me dije që mbledhjes ju bashkua dhe këshilltarja Anjeza Proshka. Para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës kemi një projektvendim shtesë të cilin e gjeni të fotokopjuar para gjithsecili me titull, “Për miratimin e projektit, ‘Tungjatjeta Jetë’ shërbim lëvizës për fëmijë me aftësi të kufizuar. Jeni dakord ta përfshijmë në rendin e ditës? Atëherë të gjithë janë dakord. Miratohet.

- Miratohet me 13-vota pro përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit me shkresë Nr.780.Prot datë 27.02.2023 “Titulli i projektit : Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar“.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, Miratimi i rendit të ditës. Kush është dakord? Të gjithë janë dakord. Miratohet.

-Miratohet me 13 vota pro pika e 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.1, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 20.01.2023. Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Të gjithë dakord. Miratohet.

-Miratohet me 13 vota pro pika e 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Pika nr. 3, Miratimi i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.



Fjala për përgjegjësin e Shërbimit Social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian.

Ledian Hasani . Përshëndetje! Në total janë 26 familje përfituese me një fond prej 129 mijë lekësh të reja.

Mukades Gixhari . Besoj se materialet i keni të gjithë. Diskutim, pyetje në lidhje me këtë pikë? E hedhim në votim. Kush është pro, kundra, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13 vota pro pika e 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr. 3 . Miratohet me 13-vota pro projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.658.Prot datë 16.02.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6% “.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. Fjala për z. Ledian.

Ledian Hasani . Janë 21 familje përfituese dhe fondi është 84 mijë lekë të reja.

Luan Sheshi . Janë shtuar?

Ledian Hasani . Po, janë shtuar disa. Pak janë shtuar nuk është se janë shtuar shumë, ka pasur më tepër kërkesa.

Enver Memolla . Këto janë për të gjithë Bashkinë, përfshirë njësitë ?

Ledian Hasani . Po po i kam ndarë unë aty Rrogozhinë, Gosë, Kryevidh.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim tjetër rreth pikës 4? E hedhim në votim. Kush është pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13 vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr. 4 . Miratohet me 13-vota pro projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.634.Prot datë 15.02.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.



Mukades Gixhari . Faleminderit Ledian. Kalojmë në pikën 5. Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e planit të emergjencave civile 2023 dhe dokumentin për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut për Bashkinë Rrogozhinë”. Fjala për përgjegjësin e sektorit të emergjencave civile z. Adriatik Leka.

Adriatik Leka . Atëherë përshëndetje! Dokumentet besoj i keni përpara. Plani i emergjencave civile bazohet në ligjin nr. 45/2019 dhe konsiston në problematikën që shfaq ose ka Bashkia Rrogozhinë në marrjen e masave për parandalimin e fatkeqësive natyrore ku hyjnë: tërmetet, zjarret, rrëshkitjet, dëborë ne nuk kemi dhe pandemitë. Plani i emergjencave civile është punuar gati ky është viti i dytë, ka të dhëna për çdo njësi vendore si numër popullsie, numër banesash, kanale të para të dymta tokë në erozion ujëmbledhësat edhe strukturën e çdo njësie vendore që në rast emergjence si duhet të veprojnë. Krahas planit është dhe menaxhimi i riskut edhe ky ka për qëllim evidentimin dhe parandalimin sa të mundemi të problemeve që mund të dalin gjatë vitit. Edhe detyrat e njësisë vendore Bashkisë duhet parashikimin e fondeve që duhet të jetë 4 % e buxhetit të bashkisë duhet të parashikohet për emergjencat civile. Qëllimi i tij është që ne të konstatojmë ku janë pikat më emergjente me rrëshkitjet e dherave me lumenjtë e të tjera, mundësisht të investojmë t’i parandalojmë që nesër mos kemi dëme më të mëdha në njerëz dhe në pasuri. Krahas asaj janë dhe kapacitetet që ka Bashkia njerëzore dhe logjistike, e keni në fund ku hyjnë të gjithë mjetet që ka Bashkia këtu ka dhe bashkëpunim me privatën me spitalin me ujësjellësin të gjitha çfarë kemi ne si njësi që mund t’i vijmë në ndihmë komunitetit. Me pak fjalë kjo është në vija të përgjithshme, atë dokumentin e keni për çdo njësi vendore.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Ndonjë pyetje?

Reshit Kala . Ka pjesë që duhen ndryshuar se lexoj qyteti Kavajë rrethi Kavajë.

Adriatik Leka . Atëherë këta janë marrë në kohën që ka qenë bordi dhe ndryshimin tani e bën drejtorja e bujqësisë unë thjeshtë kam konstatimin . Tani mirëmbajtjen, unë psh kam gjendjen kush është mirë kush ka ndërhyrje etj dhe ja jap pastaj bujqësisë për të ndërhyrë. Tani drejtoria e bujqësisë e ka sot në rend dite edhe ajo kur t’i mbarojë ndryshimet dhe konstatimet atëherë do t’i bëjmë dhe ne. Unë e kam marrë nga bordi këtë, qëkur ka qenë bordi i kullimit prandaj është Kavajë.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim tjetër ndonjë pyetje? Atëherë e hedhim në votim. Po, z. Petrit Haska.

Petrit Haska . Luzi Madh 6000 ha tokë nuk të bien në sy fare ty kjo? Mua më duken se këto



janë formal sa me na i sjellë ne këtu kot, kur Luzi ka 1000 ha tokë.

Adriatik Leka . Unë nuk po ndaj toka ...

Petrit Haska . Por duhet të jesh më i kujdesshëm kur na sjell shifra .

Adriatik Leka . Shifrat kanë ardhur në bazë të zyrave.

Petrit Haska . Këto shifra po rrijnë si para 10 viteve kur ka qenë bordi... bordi është shkrirë që në kohën e Beqirit, ka kaluar në Durrës.

Adriatik Leka . Sa ka Luzi i Madh edhe njëherë, sa e ke ti?

Petrit Haska . 1000 ha. Ne e kemi 6009.

Adriatik Leka . Njësia në metra, është tokë arë sipërfaqja tokë kodrinore, numri i shtëpiave, popullsia... tek toka atëherë ta verifikojmë dhe sektori i bujqësisë sepse këto janë marrë ...

Petrit Haska . Për vete ju se unë i di këto.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër? Atëherë e hedhim në votim. Po z. Luan.

Adriatik Leka . Ato ndryshojnë vazhdimisht, çfarë kanë sjellë njësitë vendore administratorët për Gosën administratori...

Avni Kasa . Bexhet Beu nuk është më administrator, që na vjen në emrin e këtij, kujt t'i kërkojmë llogari këtij apo Altin Memës?

Luan Sheshi . Rishikoje materialin..

Adriatik Leka . Jo sa herë ka ndryshime do vijë në Këshill, tek faqja e dytë ke komisionin e emergjencave, atëherë shih komisionin e emergjencave këta janë Edison Memolla, Lutfi Kashari, Antonela, Valmira Troka, Altin Mema, Mexhit Saliu, Elton Sula, Rezart Vogli, Orges Tosku, Geraldo Gjini, Olsi Dranga, Helidon Plaku, Andi Proshka, Fatmir Meçaj, Adriatik Leka, Elis Kacani psh ka lëvizur që pardje unë nuk do bëj ndryshime për sot. Ruzhdi Juba, Denis Dedej, Besnik Dushku, Edmond Memolla është i OSHE-së, Prefektura dhe Policinë e kam lënë pa emër.



Ky është komisioni, ky është më i freskëti këta lëvizin, unë materialin ka gati dy muaj që e kam bërë, kur këta lëvizin prap do i bëj korrigjimet nga mbrapa.

Emiliano Aliu . Më fal, ka gjëra që mund të ndryshohen ka dhe gjëra që nuk ndryshohen në rastin tonë unë jam me ty nuk është problemi... çështja është ai duhet ta mbajë të përditësuar databazën me komisionet dhe me njerëzit. E rëndësishme është të shikohet plani i emergjencave, menaxhimi i riskut se sa përmbajtja e njerëzve. Normalisht ka të drejtë Petriti kur tha për numrin se në bazë të numrit do shohësh dhe mundësinë e përballjes që do kesh në rastet e emergjencës, kjo po numri i metrave katrorë ka të bëjë por i personave ato ndryshojnë. Mund të vendosësh personin përgjegjës administratorin pa vendosur emër dhe je në rregull, kush ndryshon e përditëson je ok, dmth vendos titullin mos vendos emrin e personit sepse ato ndryshohen përderisa ato ndryshohen edhe kolegët po venë në dukje më mirë vendos titullin.

Adriatik Leka . Komisioni emergjencave del me urdhër të Kryetarit.

Emiliano Aliu . Del me urdhër kryetari e mban zëvendësohet ja çon prap kryetarit ato janë procedura që do mbash për vete.

Petrit Haska . Kryetare unë nuk jam dakord ju të tjerët bëni si të doni.

Emiliano Aliu . Nuk je dakord vetëm për metrat?

Petrit Haska . Vijnë letrat formal këtu, asgjë të saktë, vetëm komisioni por faktet tjera nuk përputhen asnjë.

Adriatik Leka . Unë nuk i kam marrë nga kadastra...

Petrit Haska . Puna e jote kur të na i sjellësh ne, ne duam letra të sakta, sipas kadastrës sipas prefekturës ti je për atë punë jo unë.

Emiliano Aliu . Dokumenti duhet rregulluar me ato gjëra që duhen por organizimi që unë shoh organigrama dhe çdo gjë tjetër si dokument po flas për vete, ti ke votën tëndë po shoh më shumë për numrat... E dini që shumica e njerëzve nuk dinë numrat e emergjencave? Një nga ata jam dhe unë dmth kur them këtë të paktën nëpër shkolla duhen vendosur. Në çdo hyrje pallati janë vendosur nga Bashkia e Tiranës unë nuk kam kohë që t'i futem në detaje planit të menaxhimit të riskut por më pëlqen shumë se shoh vetëm shifra ja problemet e njësisë janë të analizuara, administratën e keni ngritur numrin e telefonit të administratorit e keni vendosur thashë struktura



duhet sepse kjo është puna jote këtë ta kesh ti, thashë unë nuk e di pse ka ardhur me emra mbiemra këtu por normalisht do kalojë si dokument kështu që duhen bërë modifikimet e nevojshme për emrat dhe numrat siç tha z. Petrit por gjë tjetër unë ...

Adriatik Leka . Atëherë për numrat e ka drejtorja e bujqësisë unë kam thjeshtë ngritjen e problemit emergjent. Unë kam thjeshtë marrim një rast psh lumi Shkumbin po çan tokën në Vilë Bashtovë atëherë unë kam kërkuar nga Instituti i Gjeoshkencës kanë ardhur kanë bërë verifikimin kanë bërë rekomandimin pastaj se sa metra është dhe si ndiqet nuk e ndjekim më ne. Ne e ngrijmë problemin kërkojmë ta parandalojmë.

Emiliano Aliu . Nga analiza që bëhet 67 km janë rrugë të paasfaltuara të cilat në perspektivë duhet të shtrohen për t'i ardhur në ndihmë banorëve të fshatrave, turizimit etj.

Adriatik Leka . Në bazë të fshatrave distanca mes tyre ka dalë ajo shumë.

Emiliano Aliu . Do doja të shihja dhe në menaxhimin e riskut se ti je ekspert unë jam thjeshtë lexues dua të di në rast se nga prurjet e shumta që do ketë se thatësiro ka kur ka rënë niveli i ujit dhe në Venecia pale në vende të tjera dhe duhet marrë për ujin e pijshëm si do bëhet, dy në rast të reshjeve të shumta shumica e përrenjve dalin jashtë kanalizimeve, jashtë shtratit bllokohen rrugët...

Adriatik Leka . Po ta lexosh me vëmendje aty është dhe për ujërat për zjarret për rrëshkitjen e dheut metrat mund të mos jenë taman.

Emiliano Aliu . Ato janë gjëra që rregullohen për mendimin tim kur kjo përkthehet në shumë koeficienti për shkak financiar kurse kur është thjeshtë për informacion...

Adriatik Leka . Atëherë për shkak financiar nuk e bëjmë ne preventivin e bën drejtorja përkatëse e bën pyjorja kupton.

Emiliano Aliu . Unë nuk kam gjë për të thënë se dokumenti i parashtron të gjitha.

Luan Sheshi . Shikoj Njësinë Administrative Gosë, tokat thotë nga erozioni vertikalisht nënkuptohet kjo pjesa e Shkumbinit?

Adriatik Leka . Po, me rrezikshmëri për erozion nga Shkumbini, e gjithë sipërfaqja ku fillon pjesa e Bashkisë Rrogozhinë deri në dalje klasifikohet tokë në erozion çfarë janë në breg të



Shkumbinit, Lushnja i ka ndarë tek ura e Çopanit.

Emiliano Aliu . Kolegë në qoftë se keni ndonjë problem ju me personat nëse keni ndonjë problem toke rrezik zjarri edhe që mund të ja drejtoni direkt gjeni një përgjigje...

Adriatik Leka . Po ta shikosh dhe ato janë të konstatuara Njësinë Gosë, Lekaj, Kryevidh.

Luan Sheshi . Emiliano, Adriatiku nuk është se ka ardhur i papregatitur këtu për rrezik zjarri. Rrezik zjarri mund të vijë dhe nesër ato e dinë zonën unë e kam më shumë tek shifrat...

Emiliano Aliu . Shifrat numrat atë e thamë duhen rregulluar. Dua të them këtë që për një shifër që mund të rregullohet... Përmbajtja është në rregull ai strukturën e ka bërë organigrama sa herë ndërrohet firmoset nga kryetari i bashkisë nuk ka pse i hyjmë më në detaje këtyre...

Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim. Pro?

Emiliano Aliu . Vetëm Petritin kemi. Je kundër abstenon?

Mukades Gixhari . 12 pro dhe 1 kundër. Miratohet.

Miratohet me 12 vota pro 1 kundër pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr. 5 . Miratohet me 12-vota pro, 1 kundër projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.649.Prot datë 16.02.2023 “Për miratimin e planit të emergjencave civile 2023 dhe dokumentin për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut për Bashkinë Rrogozhinë“ respektivisht vjen me Nr.647.Prot datë 16.02.2023 Plani i Emergjencave dhe me Nr.648.Prot datë 16.02.2023 dokumenti i menaxhimit të riskut.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Adriatik. Kalojmë në pikën 6-të, Miratim i projekt-vendimit, “Për mbylljen e disiplinimin e varrezës të fshatit Zeshtik, Njësia Administrative Kryevidh”. Përgjegjësi i sektorit juridik z. Luan Gjuzi dhe drejtori i Politikave Urbane z. Geraldo Gjini.

Luan Gjuzi . Nuk e di e keni projektvendimin dhe relacionin?

Mukades Gixhari . E kanë të gjithë.

Luan Gjuzi . Bashkia Rrogozhinë kërkon zhvendosjen e 4 varreve të vjetra që janë në fshatin



Zeshtik, njësia administrative Kryevidh. Parcela ku ndodhen këto 4 varre sipas planit vendor urbanistik është lulishte. Këto 4 varre do zhvendosen tek varrezat publike të fshatit Zeshtik Njësia Administrative Kryevidh.

Luan Sheshi . Janë dakord familjarët?

Luan Gjuzi . Edhe njëherë është detyra jonë pasi ajo aty sipas planit vendor urbanistik nuk është varrezë.

Luan Sheshi . Çfarë është?

Luan Gjuzi . Lulishte.

Luan Sheshi . Ku është kjo se unë Zeshtikun e njoh.

Fatmira Thartori . Përpara se të bëhet diçka e tillë merret mendimi dhe bëhet dëgjesa publike, pra përpara se të vini këtu tek ne dhe ne ta miratojmë këtë duhet të jenë dakord banorët e asaj zone atje pastaj të veprohet tek kjo pjesa, duhet bërë dëgjesa publike.

Luan Gjuzi . Nuk janë të interesuar.

Fatmira Thartori . Keni lënë takim me bërë dëgjësën publike dhe nuk janë paraqitur?

Luan Gjuzi . Këto varre janë të vjetra zona nuk është varrezë...

Fatmira Thartori . Sido që të jetë janë gjyshërit dhe stërgjyshërit e atyre banorëve atje. Keni lënë afate kohore nga kjo datë nga kjo orë ne do vijmë dhe do bëjmë dëgjësën tek kjo zonë?

Luan Gjuzi . Jo.

Fatmira Thartori . Atëherë të paktën për mendimin tim duhet studiuar situata pastaj veprohet.

Luan Gjuzi . Bashkia ka të drejtë të ndërhyjë tek varrezat e vjetra t'i disiplinojë varret.

Fatmira Thartori . Nuk jemi kundër që të mos disiplinohen ato por përpara duhet të bëhen publike hapat.



Emiliano Aliu . Prishen banesa për interes publik por nuk kushton absolutisht asgjë që të merret një mendim nga familjarët sepse ne i detyrohemi atyre banorëve. Ti nga ana juridike ke të gjithë të drejtat sapo i the por problemi është si Bashkia si njerëzore si morale dhe ta kaloje në këshill bashkiak nuk thotë njeri gjë.

Luan Gjuzi . Korniza ligjore është në rregull.

Emiliano Aliu . Je në rregull sepse thashë po prishen banesa e pallate për interesa të mëdha publike.

Luan Gjuzi . Do kalojnë nga të vjetrat do disiplinohen tek varrezat publike, do spostohen.

Luan Sheshi . Po a janë dakord familjarët.

Geraldo Gjini . Ato janë varre 85-vjeçare me çfarë kemi folur me administratorin e Njësisë me Çimin ai është marrë me këto që i ka pyetur familjarët ka nxjerrë dhe emrat por deklaratë nuk kemi marrë.

Luan Sheshi . Tani ti marrësh deklaratë familjarëve se ti po i zhvarros.

Emiliano Aliu . Të ngrenë një padi civile direkt e di që kanë të drejtë se është njësoj sikur të gjesh një zonë arkeologjike ki kujdes po them dhe nga ana juridike. Prandaj më mirë lëre, ti për interes publik nuk është se po i shkul... po i disiplinon. Ka njerëz që nuk që eshtrat e gjyshërve... unë kam të stërgjyshërve të mi, unë i kam lëvizur por ama më kanë lajmëruar Bashkia jo tani por flas në kohën e Enverit.

Luan Sheshi . Emiliano kalon një kohë dhe siç i thuhet varr pa emër edhe atij e do një... hyn tek trashëgimia kulturore jo 85-vjeçar.

Enver Memolla . Ne po flasim për një çështje që ka ndjeshmëri të lartë janë për familjarë që kanë humbur, familjarët e sotëm nipa apo mbesa mund të jenë gjallë nuk është fakti se kemi një shembull në Rrogozhinë lagja e “Gjuzëve” që u shemb është prish varreza, po flasim për prishje varreze për të krijuar diçka të mirë publike dhe realisht duhet të jetë njoftimi zyrtar i Bashkisë Rrogozhinë dhe njoftimi zyrtar që Bashkia Rrogozhinë ka marrë nga ato banorë bashkë me kryetarin e komunës që mungon, kryeplaku i plotfuqishmi i zonës. Tani kjo është një çështje shumë e ndjeshme sepse do e kalojmë dhe nesër do thuhet e kaloi këshilli, pa dorashka kjo histori. Kështu që kjo pjesë duhet parë pak më me thellësi me të vërtetë mund të jenë tre, katër,



pesë, një dy varreza por aty faktikisht janë eshtrat e dikujt. Bashkia do duhej faktisht që pastaj dhe marrja e masave në projektvendim ndoshta i keni marrë tek pjesa e mënyrës së lëvizjes...

Luan Gjuzi . Ato janë me agjenci funerale.

Enver Memolla . Por ama familjarë të afërm duhej të ishin prezentë për mendimin tim të paktën duhet të ishin një përfaqësi e tyre, kryetari i komunës dhe kryeplaku sepse ne të dëgjojmë ty, ti me letra je ok kryetarin e komunës nuk e dëgjojmë, kryeplakun nuk e dëgjojmë, del nesër dalim “Përrallë nga e kaluara” se jemi mësuar i miratoi këshilli bashkiak. Unë jam i mendimit që ky projektvendim të kaloj për radhën tjetër.

Luan Gjuzi . Apo ta ashtu... që brenda 4-5 ditëve të jepet relacion.

Emiliano Aliu . Por problemi është jo se duhet të kalojë me vendim këshilli bashkiak, përderisa do të kalojë me vendim do të sugjeroja siç tha e shtyjme për herën tjetër duhet shtyrë për herën tjetër. Po mirë është edhe pse biseduat në qoftë se nuk e merrni dot me shkrim një audioviziv duhet ose një përfaqësi ta sjellim këtu duhet. Duhet dhe nga kryeplaku sepse kryeplaku e di se si, është çështja e njerëzve që banojnë atje...

Enver Memolla . Emiliano çështjen për kryeplakun e preka sepse nuk është këtu ai...

Emiliano Aliu . Ja ta analizojmë, e kaluam ne e para e punës mund të ta kthejë Prefekti mungon relacioni, marrim tjetrën do çohet ndonjë banor pas dy gotave raki do thotë ku janë varret e të parëve të mi?

Luan Sheshi . Bëhet barcaletë...

Luan Gjuzi . Kjo që po shtrojmë është humane ndërsa ligji ...

Emiliano Aliu . Sapo ta thashë me ligjin je në rregull...

Enver Memolla . Me ligjin në rregull... Sugjerimi është bërë nga kryetar i komunës?

Luan Gjuzi . Nga zyra e urbanistikës.

Enver Memolla . Kryetari i komunës atje është njoftuar për këtë çështje kaq të ndjeshme?



Luan Gjuzi . Unë po them nga ana humane jam plotësisht me ju por nga ana ligjore është taksative shteti ndërhy...

Enver Memolla . Nuk po them se nuk ndërhy shteti...

Petrit Haska . Unë kam një sugjerim tjetër, ne kur kemi nevojë për varreza i drejtohem Bashkisë dhe e gjen rrugën Bashkia ku do i çojë varrezat. Në qoftë se ne do pyesim atje njëri ka gjyshin, tjetri ka gjyshen mos e bëjmë, ne nuk gjejmë rrugëzgjidhje, do pyetur ai do pyetur ky...

Luan Sheshi . Petrit ka lënë fëmijë pas ai?

Petrit Haska . Varrose matanë...

Emiliano Aliu . Tani nuk bëhet fjalë për të kërkuar vend për të varrosur, gjithsesi duhen pyetur të kishim një shkresë të ishte shkresa këtu...

Mukades Gixhari . Atëherë në bazë të diskutimeve të juaja të nderuar këshilltarë, mendoj që këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjme për mbledhjen e radhës.

Luan Gjuzi . Plotësojmë vetëm deklaratat po na i dhanë.

Mukades Gixhari . Po, faleminderit. Ke dhe një pikë tjetër, pika 7 miratim i projekt-vendimit, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit ‘Rrugët sipër hekurudhës’ faza e I-rë”.

Luan Gjuzi . Bashkia kërkon të shpronësojë me fondet e veta një sipërfaqe toke të pronarëve tek lagjja nr.1, blloku “Çetë” pjesërisht është zënë nga rruga është projekti në zbatim dhe pjesa tjetër parashikohet të ndërtohet lulishte, park. Është një sipërfaqe 700 plus 600 m².

Enver Memolla . Kjo është tek shtëpia, tek dyqani i Bim Hoxhës dhe aktualisht në atë lagje duke parë që zotëria ku është toka është pronar ka konflikte me rrugën me 3-4 familje të tjera. Unë e di shumë mirë rastin konkret se kanë ardhur banorët, ka ardhur vetë ky që është përfitues që është pronar dhe faktikisht ky është bërë një problem për bashkinë Rrogozhinë mesa di unë që ka pasur dhe ankesa për zënie rrugësh. Ka qenë dhe policia bashkiake që është marrë në telefon nga Rustem Gjini nuk e di tani kjo paguhet nga Bashkia Rrogozhinë apo nga fondi i rrugës që është bërë?



Luan Gjuzi . Pjesërisht nga fondi i rrugës, pjesërisht do shpronësohet nga Bashkia.

Enver Memolla . Sepse tek projekti i rrugës ka qenë një minifushë një lulishte aty që nuk është bërë akoma.

Geraldo Gjini . Mund ta shpjegoj unë këtë pjesë se jam në brendësi. Aty projekti i rrugës ka qenë për të bërë një fushë dhe një park i vogël dhe në kuadër të saj është kërkuar nga ne shpronësimi sepse ai zotëria nuk na lejon pa e bërë shpronësimin. Shpronësimi bëhet nga Bashkia pjesa e projektit pastaj do zhvillohet me fondet që ka qenë...

Enver Memolla . Atëherë një pyetje e drejtpërdrejtë, ky shpronësim i këtij e zgjidh problemin e këtyre konflikteve?

Geraldo Gjini . Po e zgjidh.

Luan Gjuzi . Po, e zgjidh konfliktin e rrugës.

Luan Sheshi . Ka fonde Bashkia për shpronësimin?

Luan Gjuzi . 4 milionë lekë të vjetra janë.

Luan Sheshi . Po 4 milionë këtu, 4 atje pak nga pak bëhet shumë.

Luan Gjuzi . Po zihet rruga.

Geraldo Gjini . Ne kemi një projekt të miratuar që jemi të detyruar që ta fusim për shpronësim.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim tjetër? Po znj. Fatmira.

Fatmira Thartori . Siç e tha dhe Veri. A janë në dijeni ato që do shpronësohen?

Luan Gjuzi . Edhe njëherë shpronësimi sipas legjislacionit të shpronësimit shteti nuk pyet, të shpronëson për interesa publike. Në qoftë se personi i interesuar nuk është dakord vetëm me njësinë e masës së çmimit ka të drejtë ta ankimojë vendimin. Nuk e di a më kuptoni? Është taksative ndërhyrje shteti, do s' do ti dhe unë për shpronësime për interesa publike. Vetëm çmimi dhe ai është me referencë në bazë të VKM.



Mukades Gixhari . Atëherë e hedhim në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

Miratohet me 13 vota pro pika 7 (shtatë) e rendit të ditës

Vendim nr. 6 . Miratohet me 13-vota pro projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.781.Prot datë 27.02.2023 dhe relacionin me shkresë Nr.781/1 datë 27.02.2023 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit ‘Rrugët sipër hekurudhës’ faza e I-rë“.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Kalojmë në pikën 8-të, raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë. Në lidhje me këtë çështje ne do na referonte z. Andi Proshka por për një obligim familjar ai nuk pati mundësi që të vinte dhe mendoj që ta shtyjmë për mbledhjen e radhës.

Enver Memolla . Meqenëse kjo pikë 8 është pjesë e bujqësisë dhe unë radhën tjetër dua një raport mbi tokat që janë dëmtuar nga lumi Shkumbin nga erozioni, sa është sipërfaqja e tyre të paktën për qytetin Rrogozhinë të dëmtuara nga gërryerja erozioni. Sepse po hasim në njerëz konkretë që nuk po ç’regjistrojnë dot, ja ka marrë Shkumbini dhe nuk po e ç’regjistrojnë dot, taksat janë paguar hipoteka se heq.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek projektvendimi. Për ta shtuar? Shkruaje Visi.

Petrit Haska . Për radhën tjetër kërkoj kapacitetin faktik të rezervuarit të Okshtunit sa është sot, sa do vadisim. Jo është mesatar është kështu e ashtu... të gjitha formal i kanë. Megjithatë le ta masin kur të vijmë.

Emiliano Aliu . Qaj hallin se si do t’i masin.

Petrit Haska . Po nuk ditën me matur, i mas unë.

Emiliano Aliu . Me sy do t’i masësh?

Petrit Haska . Jo me sy, ka metër.

Mukades Gixhari . Tani para se të kalojmë tek të ndryshmet kemi projektvendimin “Tungjatjeta



jetë, shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”, që e përfshimë në rendin e ditës në fillim. Kemi drejtorin e financave Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Përshëndetje! Projekti “Tungjatjeta Jetë” është një projekt që konsiston në shërbimin lëvizës që i ofrohet fëmijëve me aftësi të kufizuar në Bashkinë Rrogozhinë. Ky është viti i tretë që ofrohet në Bashkinë Rrogozhinë, dy vitet e kaluara u financua 100% nga ana e “Word Vision” partnerë që ishin në këtë projekt ndërsa në këtë vit që jemi pas një takimi që kemi pasur me Shërbimin Social ku projektin e menaxhojnë ato, na është ofruar mundësia për një financim të projektit, 60% të fondit që na nevojitet për paga dhe sigurime të stafit do mbulohet nga ana e shërbimit social dhe 40 % mbulohet nga ana e Bashkisë.

Luan Sheshi . Shërbimi Social shtetëror?

Rezart Vogli . Shtetëror. Pagat e përcaktuara nga ana e “Word Vision” e dy viteve të kaluara ishin në një nivel mbi mesataren që ofrohen në Bashkinë Rrogozhinë. Ne referuar pagave që ofrohen për specialistët e Bashkisë Rrogozhinë kemi bërë dhe rregullimin e pagave për punonjësit e projektit. Dhe e kishim vjet fondin në total 4 milion e 416 mijë ndërsa sivjet fondi është 3 milion e 600 mijë nga ana e shërbimit social me shkresë nr.398.prot datë 13.01.2023 na është akorduar fondi nga ana e shërbimit social shtetëror prej 2 milion e 192 mijë lekë. Për të plotësuar fondin që na nevojitet për mbulimin e pagave dhe sigurimeve për stafin prej 6 punonjësish edhe 1 milion e 415 mijë lekë duke parë anën pozitive si e kanë mirëpritur familjarët e këtyre prindërve na shtyu dhe na bën që ne ta vazhdojmë edhe këtë vit projektin “Tungjatjeta Jetë” në Bashkinë e Rrogozhinës përderisa jemi fitues në pak Bashki që ofrohet.

Luan Sheshi . Ka qenë parashikuar tek buxheti kjo pjesë?

Rezart Vogli . Është parashikuar ka qenë sepse është diskutuar përpara nga ana e stafit të shërbimit social nga takimi që kemi pasur dhe me kryetarin e bashkisë në zyrë ato shprehën dëshirën dhe gatishmërinë dhe u treguan shumë pozitivë nga ana e tyre pasi jo në dijeninë tonë por ne e morëm vesh aty në ato momente që ato kishin pasur telefonata kishin pasur kontakte me familjarë dhe ishin shumë të kënaqur nga shërbimi që ishte ofruar.

Anjeza Proshka . Shërbimi vazhdon në familje apo në qendër?

Rezart Vogli . Shërbimi vazhdon e përfitojnë 36 fëmijë, janë 24 fëmijë në Bashkinë Rrogozhinë, 3 fëmijë janë në Gosë të Madhe, 1 Gosë e Vogël, 1 Vilë Bashtovë, 1 në Stërbeg, 1 Greth i Mesëm, 1 Sinaballaj, 2 në Kryevidh dhe 2 fëmijë në Zhabjak. Për shkak ndjeshmërie unë nuk e



pashë të arsyeshme t'i bashkëngjisja listën e fëmijëve se kanë diagnoza të ndryshme.

Emiliano Aliu . Jo nuk na duhen çështja është përderisa vetë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale na ka akorduar fondin ne nuk na mbetet gjë tjetër që të japim ok për 14 milionëshin tjetër dhe mbaroi muhabeti.

Rezart Vogli . Bëhet fjalë për 36 fëmijë ku shërbimi ofrohet në shtëpi ...

Emiliano Aliu . Rezi a ka kaluar Ministria ka kaluar 21 milionë lekë përderisa i kanë kaluar ato...

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje tjetër? Atëherë e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

Miratohet me 13 vota pro projekt-vendimi me shkresë Nr.780.Prot datë 27.02.2023 “Titulli i projektit : Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar“.

Vendim nr. 7 . Miratohet me 13-vota pro projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.780.Prot datë 27.02.2023 “Titulli i projektit : Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar“.

Mukades Gixhari . Faleminderit Rezi. Jemi tek të ndryshmet. Çfarë keni ndonjë gjë tek të ndryshmet? Atëherë znj. Margarita.

Margarita Dedej . Një pyetje a keni informacion se kur do mbarojë rikonstruksioni i “Xhorxh Soros”? Dhe nëse keni, a ka mundësi të marr një përgjigje? Unë jam palë e interesuar.

Luan Sheshi . Në dijeninë time fjala është që brenda Marsit por të saktë... Ishte Mario këtu...

Mukades Gixhari . z, Avni Kasa.

Avni Kasa . Si shpjegohet që ne miratojmë këtu çdo gjë, deri sot i kemi miratuar të gjitha. Bashkia i kërkon llogari firmës pastruese të plehrave më shumë turp 2 javë bëhemi ne “legenë” atje, njerëzirt na kapin prej gurmazi, ju votojmë edhe nuk shërbejmë. Këtu nuk ka asnjë përfaqësues të Bashkisë ku ta marrim përgjigjen? Edhe tjetra ka ardhur përroi mbrëmë ka lënë tubën tek ura do prishi dhe atë që është bërë.



Mukades Gixhari . Tek ura që vjen në Gërmej?

Avni Kasa . Po, duhet një skrep i madh.

Emiliano Aliu . Po aty e kishe pse nuk ja the.

Avni Kasa . Emergjencave Civile?

Emiliano Aliu . Pikërisht se ajo që doli do të thotë që ka nevojë emergjente.

Luan Sheshi . Emiliano ai material ishte 12-13 vjet më përpara.

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak z. Enver.

Enver Memolla . Tani të gjithë e dimë që jemi Live.

Mukades Gixhari . Pikërisht nuk duhet ta harrojmë.

Enver Memolla . Kam parë një problem këto ditë tek rrethimi që është bërë në rikonstruksionin e shkollës “Xhorxh Soros” dhe palestra që është para, ato kangjellat aty janë shumë të rrezikshme për fëmijët e vegjël. Janë rrëzuar fëmijët kanë rënë hekurat tani vetëm Rezi ka mbetur kur bëhen diskutime mbledhjet e fundit tonat hajt më u pa puna por... Punimet tek shkolla e di që po vazhdojnë por po rrezikohet jeta e fëmijëve si tek ngjitja e shkallëve si tek rrethimi me ato kangjellat 2 metroshe ku një fëmijë ta preki e zë sipër. Raportojnë dhe ikin, raporto dhe rri prit çfarë do thotë pjesa tjetër se hajde raportova unë mbylla pjesën time u ngrita ika 10 vetë anulohet mbledhja, e ka fajin Këshilli Bashkiak... nuk e di nuk e konceptoj dot këtë pjesë.

Mukades Gixhari . Po, Mario.

Mario Meka . UNDP-ja të Enjten tha që do vijë do bëjë atë inspektimin e vet ...

Mukades Gixhari . Për Xhorxh Soros bëhet fjalë.

Enver Memolla . E kam për rrethimin...

Mario Meka . UNDP-ja praktikisht është ai që e ka bërë nuk e ka bërë bashkia mund ta ngrejme



këtë çështje bashkë me Luanin se aty do jemi që t'i themi për këtë. Afati i fundit që kanë këto, ka mbaruar çdo afat dhe afati i fundit që kanë mos gaboj është 29 Mars.

Luan Sheshi . Afati i shtyrë?

Mario Meka . Po i shtyrë nuk shtyhet dot më edhe Lekaj po e njëjta gjë është bërë nuk shtyhet dot më.

Anjeza Proshka . Xhorxhi është në përfundim ndërsa për Lekaj...

Mario Meka . Është afati i fundit pastaj fillojnë gjobat trefish.

Enver Memolla . Edhe një diskutim tjetër meqenëse është dhe drejtori Rezarti. Për pjesën e bonusit të qerasë për personat që nuk kanë filluar bërjen e shtëpisë do presin grantin ka ndonjë informacion?

Rezart Vogli . Shtëpiat që janë akoma në proces presim nga ana e Ministrisë akordimin e fondit nuk është çel akoma për këtë vit buxhet, presim kemi sinjale pozitive që do vazhdojë punë.

Mukades Gixhari . Znj . Vojsava.

Vojsava Pipa . Kam ngritur një problem për prishjen e rrugicës përballë policisë jo vetëm që nuk u rregullua por vazhdon akoma prishja. Ujësjetësi ka hapur një gropë të madhe atje është bërë baltë zhavorr.

Mukades Gixhari . Po faleminderit znj. Vojsava. Diskutime tjera? Meqë nuk kemi diskutime të tjera mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Faleminderit të gjithëve.

-Këshilltarët përshëndesin njëri tjetrin.

MBYLLET MBLEDHJA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 00^{oo} . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total : 47 min ; 23 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 20 (njëzet).

Miratohet procesverbali :

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**